



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2023 – Numri: 59

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 6 prill 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 19/2023, datë 16.3.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian” 6631
Dekret i Presidentit nr. 46, datë 31.3.2023	Për shpallje ligji..... 6635
Ligj nr. 20/2023, datë 16.3.2023	Për bletarinë..... 6635
Dekret i Presidentit nr. 49, datë 3.4.2023	Për shpallje ligji..... 6644
Ligj nr. 21/2023, datë 16.3.2023	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 6644
Dekret i Presidentit nr. 50, datë 3.4.2023	Për shpallje ligji..... 6647
Ligj nr. 22/2023, datë 16.3.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për krijimin e task-forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë..... 6647
Dekret i Presidentit nr. 47, datë 31.3.2023	Për shpallje ligji..... 6651
Ligj nr. 23/2023, datë 16.3.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për delegimin e shërbimeve të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit..... 6651
Dekret i Presidentit nr. 48, datë 31.3.2023	Për shpallje ligji 6655

Dekret i Presidentit nr. 51, datë 3.4.2023	Për emërimin e drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.....	6656
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 7, datë 27.3.2023	Për një shtesë në udhëzimin nr. 35, datë 21.9.2020, “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.....	6656
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 29.3.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 26.4.2019, “Për llojet, procedurat dhe mënyrat për lëshimin e certifikatave, si dhe formatet që do të përdoren në sistemin e arsimit dhe formimit profesional”	6658
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr. 180, datë 29.3.2023	Për përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar.....	6659



LIGJ
Nr. 19/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 15/2015
“PËR ROLIN E KUVENDIT NË
PROCESIN E INTEGRIMIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË BASHKIMIN EUROPIAN”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 2 ndryshon si më poshtë:

“Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për marrëdhëniet e Kuvendit me Këshillin e Ministrave, ministrin përgjegjës për negociatat me Bashkimin European, institucionet e pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.”

Neni 2

Në nenin 3 pas shkronjës “b” shtohen shkronjat “b/1”, “b/2” dhe “b/3” me këtë përmbajtje:

“b/1. dhënien e rekomandimeve për pozicionet negociuese të Republikës së Shqipërisë në negociatat e anëtarësimit në Bashkimin European;

b/2. monitorimin e kriterëve të vendosura gjatë procesit të negociatave;

b/3. informimin mbi gjetjet kryesore të raportit të shqyrtimit analitik të legjislacionit të Komisionit European.”.

Neni 3

Në nenin 4 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “ë” ndryshon si më poshtë:

ë) “Legjislacioni i Bashkimit European” është korpusi i normave detyruese dhe rekomanduese në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit European.”.

2. Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:

gj) “Pozicion negociues” është pozicioni që do të prezantojë Republika e Shqipërisë për kapitujt ose grup-kapitujt.”.

Neni 4

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Këshilli Kombëtar i Integrimit European përbëhet nga:

a) kryetarët dhe nënkryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare;

b) përfaqësues të grupeve parlamentare të Kuvendit;

c) kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin;

ç) Avokati i Popullit;

d) ministri përgjegjës për integrimin dhe ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European;

dh) përfaqësues nga kabineti i Kryeministrit;

e) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme;

ë) përfaqësues nga kabineti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

f) Prokurori i Përgjithshëm;

g) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar;

gj) Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

h) përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile të përfshira në çështjet e integrimit european, të cilat i përgjigjen thirrjes për aplikim dhe ftohen për çdo grup-kapitujsh.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:



“4. Në takimet e Këshillit Kombëtar të Integritit European marrin pjesë me statusin e të ftuarit sipas tematikës së takimit:

a) titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, të cilët raportojnë dhe informojnë Kuvendin dhe që nuk përfshihen në pikën 3 të nenit 6 të ligjit ;

b) përfaqësues nga organizatat e biznesit, dhomat e tregtisë, sindikatat, të cilët i përgjigjen thirrjes për aplikim, në bazë të fushës së përgjegjësisë;

c) përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe institucionet e arsimit të lartë publik;

ç) përfaqësues nga media, të cilët i përgjigjen thirrjes për aplikim;

d) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të trupit diplomatik.

Neni 5

Neni 7 ndryshon si më poshtë:

“Neni 7

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Integritit European

“1. Këshilli Kombëtar i Integritit European ka këto përgjegjësi:

a) nxit bashkëpunimin midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura dhe shoqërisë civile në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European;

b) siguron diskutim të vazhdueshëm për politikën e integritit european, të zbatuara nga institucionet shtetërore me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar;

c) monitoron zbatimin e detyrimeve gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, jep rekomandimet përkatëse për çështjet e shqyrtuara tek institucionet përgjegjëse dhe informon sipas rastit Komisionin për Çështjet Europiane për gjetjet e konstatuara gjatë monitorimit;

ç) organizon takime me grupet e interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile për çështje që lidhen me detyrimet për hapjen dhe mbylljen e kapitujve të negociatave;

d) zhvillon takime me ministrin përgjegjës për negociatat me Bashkimin European dhe me strukturën përgjegjëse për negociatat;

dh) këshillon dhe jep opinione në lidhje me ecurinë e procesit të negociatave;

e) mban kontakte dhe shkëmben informacion me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin nëpërmjet kryetarit të Këshillit Kombëtar për Integritim European;

ë) raporton një herë në vit në Kuvend për punën e Këshillit.

2. Gjatë veprimtarisë së tij Këshilli shqyrton dhe këshillon për çështje që vlerësohen të rëndësishme për procesin e integritit european.”

Neni 6

Neni 8 ndryshon si më poshtë:

“Neni 8

Sekretariati teknik

“1. Këshilli Kombëtar i Integritit European asistohet nga Sekretariati Teknik, i cili kryen funksione këshillimore dhe administrative dhe përbëhet nga punonjësit e administratës së Kuvendit.

2. Rregulla të detajuara për përbërjen, organizimin, funksionimin, numrin e punonjësve dhe përgjegjësitë e Sekretariatit Teknik miratohen me vendim të Byrosë së Kuvendit.

3. Vendimi i Byrosë së Kuvendit për shtim të numrit të punonjësve në organikën e Kuvendit i dërgohet Këshillit të Ministrave dhe ministrisë përgjegjëse për financat për sigurimin e mbështetjes së nevojshme buxhetore për këtë qëllim.”

Neni 7

Neni 10 ndryshon si më poshtë:

“Neni 10

Komisioni për Çështjet Europiane

Komisioni për Çështjet Europiane është organ i përhershëm i Kuvendit, që ka në fushën e përgjegjësisë së tij:

a) çështjet e integritit european;



b) përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European;

c) monitorimin e zbatimit të kriterëve gjatë procesit të negociatave, angazhimeve që rrjedhin nga kuadri negociator, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe të asistencës financiare të Bashkimit European për Republikën e Shqipërisë;

ç) shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për pozicionet negociuese të Republikës së Shqipërisë.”

Neni 8

Neni 11 ndryshon si më poshtë:

“Neni 11

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit në çështjet europiane

1. Kuvendi, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, në lidhje me çështjet europiane:

a) siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European në ushtrimin e funksionit legjislativ;

b) monitoron dhe kontrollon punën e Këshillit të Ministrave, ministrit përgjegjës për negociatat me Bashkimin European, institucioneve të ngarkuara për zbatimin e detyrave në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European;

c) shqyrton raportet/konkluzionet e Bashkimit European dhe qëndrimet e Republikës së Shqipërisë, si dhe jep rekomandime mbi to;

ç) bashkëpunon me Parlamentin European dhe me parlamentet e vendeve anëtare të Bashkimit European;

d) monitoron punën e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj për çështjet e integritimit europian dhe bashkëpunon me to;

dh) bashkëpunon me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për çështjet e integritimit europian;

e) përfaqëson interesin publik në procesin e negociatave, në takime dhe në forumet e përbashkëta me institucionet europiane;

ë) informon publikun për pozicionin e institucioneve europiane dhe vendeve anëtare të Bashkimit European ndaj procesit të negociatave të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

2. Kuvendi në lidhje me çështjet europiane angazhohet edhe për:

a) vendosjen e dialogut të përshtatshëm politik ndërmjet palëve në proces;

b) monitorimin e zbatimit të kuadrit negociator, Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe asistencën financiare të Bashkimit European;

c) forcimin e bashkëpunimit rajonal për çështjet e integritimit europian.”

Neni 9

Në nenin 14 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet “Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit për Çështjet European”.

2. Në fjalinë hyrëse termi “Komisioni për Integritimin European” zëvendësohet me termin “Komisioni për Çështjet European”.

3. Pas shkronjës “ë” shtohen shkronjat “p”, “g”, “gj”, “h”, “i”, “j”, “k”, “l” me këtë përmbajtje:

f) shqyrton pozicionet negociuese të paraqitura nga struktura negociatore dhe harton një raport të posaçëm me rekomandime lidhur me këto pozicione negociuese;

g) lehtëson debatin politik dhe gjetjen e konsensusit ndërpartiak për miratimin dhe ndryshimin e ligjeve, strategjive apo rezolutave të nevojshme për përshtetimin e procesit të negociatave;

gj) kërkon raportime periodike çdo 3 muaj nga ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European për ecurinë e procesit të negociatave;

h) në bashkërendim me Komisionin për Politikën e Jashtme organizon takime dhe diskutime me parlamentet kombëtare të shteteve anëtare dhe Parlamentin European;

i) thërret për mendim, sipas nevojës, ekspertë të fushave përkatëse dhe grupe interesi;

j) mbikëqyr zbatimin e kriterëve gjatë procesit të negociatave;

k) shqyrton të gjitha marrëveshjet që lidhen me institucionet e Bashkimit European dhe/ose me vendet e Bashkimit European, si dhe marrëveshjet me karakter të mbështetjes financiare;

l) zhvillon mbledhje të përbashkëta me komisionet e tjera parlamentare për çdo projektakt që mbart ndikim në procesin e anëtarësimit.”

Neni 10

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:



“Neni 14/1

Procedura për shqyrtimin e pozicioneve negociuese

1. Ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European i paraqet Komisionit për Çështjet Europiane pozicionin negociues.

2. Komisioni për Çështjet Europiane e përfshin pozicionin negociues në kalendarin e punimeve të tij dhe e shqyrton jo më vonë se 14 ditë nga data e paraqitjes së pozicionit negociues ose brenda një afati më të ngushtë në përputhje me kalendarin e takimeve negociuese me Bashkimin European.

3. Në rast se pozicioni negociues nuk është përfshirë në kalendarin e punimeve të Komisionit brenda 4 ditëve nga data e paraqitjes të tij, ai automatikisht konsiderohet i përfshirë në kalendar dhe shqyrtohet jo më vonë se 10 ditë nga data e përfshirjes në kalendar.

4. Komisioni për Çështjet Europiane në përfundim të shqyrtimit të pozicionit negociues miraton një raport të posaçëm me rekomandime për pozicionin negociues, i cili duhet të merret parasysh nga struktura negociatore.

5. Në rast se rekomandimet e Komisionit sipas pikës 4 të këtij neni nuk merren parasysh, ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European informon me shkrim Komisionin për arsyet e mosmarrjes parasysh të rekomandimeve.

6. Struktura negociatore vijon me hartimin përfundimtar të pozicionit negociues nëse Komisioni për Çështjet Europiane nuk dërgon raportin e posaçëm me rekomandimet jo më vonë se 14 ditë nga data e paraqitjes pranë Komisionit.

7. Anëtarët e Komisionit për Çështjet Europiane hartojnë dhe nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit për marrjen në shqyrtim të pozicioneve negociuese.”

Neni 11

Në nenin 16, pika 2 , fjala “përputhjen” zëvendësohet me fjalën “përafrimin” .

Neni 12

Në nenin 17, pika 1, fjala “përputhjen” zëvendësohet me fjalën “përafrimin”.

Neni 13

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

Procedura e shqyrtimit të ligjeve që synojnë përafrimin

Komisioni për Çështjet Europiane përfshin menjëherë në kalendarin e tij të punës dhe shqyrton me përparësi ligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit.”

Neni 14

Në nenin 18 pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European informojnë në seancë plenare konkluzionet mbi negociimin e një kapitulli ose grup kapitujsh pas zhvillimit të konferencës ndërqeveritare me Bashkimin European.”.

Neni 15

Në nenin 19 pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Ministri përgjegjës për integrimin european dhe ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin European, paraqesin në fund të çdo 3-mujori në Komisionin për Çështjet Europiane një raport të hollësishëm për:

a) listën e përditësuar të projektligjeve të lidhura me çështjet e integritit european, të cilat do t'i kalojnë për shqyrtim Kuvendit për periudhën vijuese;

b) ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim;

c) tekstet e plota të raporteve të paraqitura pranë strukturave të Komisionit European apo strukturave të përbashkëta, qëndrimet për çështjet e diskutuara, si dhe konkluzionet e rekomandimet e arritura nga këto takime;

ç) agjendën e takimeve të përbashkëta të strukturave të Bashkimit European dhe Republikës së Shqipërisë të ngritura sipas Marrëveshjes së



Stabilizim-Asociimit, si dhe agjendën e takimeve të negociatave.”.

Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Ministri përgjegjës për integrimin evropian dhe ministri përgjegjës për negociatat me Bashkimin Evropian raportojnë të paktën një muaj para zhvillimit të takimit të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit për adresimin e rekomandimeve të marra prej tij nga institucionet përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë.”.

Neni 16

Kudo në ligj togfjalëshi “Komisioni për Integrimin Evropian” zëvendësohet me togfjalëshin “Komisioni për Çështjet Evropiane”.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.3.2023.

Shpallur me dekreten nr. 46, datë 31.3.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 46, datë 31.3.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 19/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015, ‘Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ Nr. 20/2023

PËR BLETARINË¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

1. Përcaktimi i rregullave për ushtrimin e aktivitetit të bletarisë, si veprimtari me interes jetësor, kombëtar, e dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë.

2. Caktimi i detyrave për autoritetet përgjegjëse.

3. Garantimi i pjalmimit natyror dhe biodiversitetit të llojeve të bletëve, me referencë të veçantë për mbrojtjen e racës së bletës (*apis mellifera carnica*), popullatave tipike vendase ose të zonave kufitare.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) nr. 1308/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 dhjetor 2013 “Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore” dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 922/72, (KEE) nr. 234/79, (KE) nr. 1037/2001 dhe (KE) nr. 1234/2007, e ndryshuar. Numri CELEX 32013R1308, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 347, datë 20.12.2013, f. 671-854.

- Direktivën e Këshillit 2001/110/KE, datë 20 dhjetor 2001 “Në lidhje me mjaltin”, e ndryshuar. Numri CELEX 32001L0110, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L nr. 10, datë 12.01.2002, f. 47-52.



1. “Apiterapi” është përdorimi mjekësor i produkteve të prodhuara nga bletët, si mjalti, propolisi, dylli, poleni, qumështi i bletës dhe helmi për të trajtuar çështje të ndryshme mjekësore dhe terapi inhalatore.

2. “Apiturizëm” është turizmi i bletëve, ku përfshihen vizitat në parkun e bletëve, njohja me aktivitetet dhe jetën e bletës, kontakti direkt me bletarë, degustimi i produkteve të bletës në vend etj.

3. “Bletari” është mbarështimi i bletëve dhe përfshin të gjitha aspektet e sektorit: njohuri për bletët, produktet e bletëve, përdorimet dhe tregjet e tyre, tregtinë e pajisjet.

4. “Bletërritja” është mbarështimi i bletëve mjaltëdhënëse.

5. “Biodiversitet” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e biodiversitetit.

6. “Bletë” është çdo insekt hymenopteran të superfamiljes apoidea, duke përfshirë speciet sociale dhe të vetmuara.

7. “Bletari shtegtuese” është një formë bletarie ku kolonitë transportohen për të ndjekur lulëzimin për prodhimin e mjaltit ose për të pjalmuar me porosi kulturat bujqësore (p.sh. bajamet, agrumet, domatet në serra), në plantacione dhe serra.

8. “Bletar” është çdo fermer, person fizik dhe juridik, që njih dhe mbron jetën e bletës, mbarështon dhe përfiton nga produktet e saj dhe mund të bëjë pjesë në shoqata lokale të bletërritësve.

9. “Bletar amator” është çdo bletar, që bletërritjen e ka aktivitet dytësor dhe zotëron deri në 10 koshere.

10. “Bletar profesionist” është çdo bletar që ushtron dhe promovon veprimtarinë e bletërritjes si aktivitet parësor dhe ka mbi 10 koshere.

11. “Parku i bletëve” është vendi i përkohshëm ose i përhershëm ku mbahen dhe mbarështohen bletët.

12. “FKBSH” është Federata Kombëtare e Bletërritësve të Shqipërisë.

13. “Koloni” është një grup organizmesh të së njëjtës specie ose grup që jetojnë ose rriten së bashku.

14. “Koshere” është banesa e bletës, pa bletë brenda.

15. “Ruajtja” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e biodiversitetit.

16. “Kullotë mjaltëdhënëse” ka kuptim e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbarështimin e blegtorisë.

17. “Mbretëreshë” nënkupton mëmën e kolonisë.

18. “Mjaltë natyral ” është substanca e ëmbël natyrale e prodhuar nga bletët *apis mellifera* prej nektarit të bimëve ose nga sekrecionet e pjesëve të gjalla të bimëve ose jashtëqitjet e insekteve që thithin bimët në pjesët e tyre të gjalla, të cilën bletët e grumbullojnë, e transformojnë duke e kombinuar me substanca specifike të tyre, e depozitojnë, e dehidratojnë, e ruajnë dhe e lënë në hojet e mjaltit për t’u pjekur dhe maturuar (stazhionuar).

19. “Mjaltë organik” është mjalti i prodhuar sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prodhimin organik.

20. “Ministria” është ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë.

21. “Ministri” është ministri përgjegjës për çështjet e bujqësisë.

22. “Shtegtim” është një ose më shumë lëvizje të bletëve gjatë vitit, me qëllim rritjen e prodhimit.

23. “Regjistri i blegtorisë” është një sistem regjistrimi i kafshëve, i cili mbahet nga institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve.

24. “Sipërmarrës të lidhur me bletën” është çdo person fizik ose juridik, që ushtron aktivitet në mbështetje të bletërritjes, si: prodhimi i koshereve, fletëve të dyllit, ushqimit të bletëve, pajisje për bletari etj.

25. “Struktura përgjegjëse” është struktura në ministri që merret me bletarinë.

26. “PMB” janë produktet e mbrojtjes së bimëve sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

27. “PMV” janë produktet e mbrojtjes veterinare sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për veterinarinë.

28. “Vendndodhja” është vendi i parkut të bletëve.

29. “Zgjuja” është kosherja që përmban një familje bletësh brenda.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për bletarët, fermerët, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë sipas dispozitave të këtij ligji.



Neni 4

Produktet e bletarisë

Konsiderohen produkte të bletarisë:

- a) mjalti;
- b) dylli i bletës;
- c) qumështi i bletës;
- ç) poleni;
- d) propolisi;
- dh) helmi i bletës;
- e) mbretëresha dhe koloni bletësh.

Neni 5

Regjistrimi i bletarëve

1. Çdo bletar që merret me bletari, që zotëron një ose më shumë zgjoje, është i detyruar të regjistrohet në:

- a) regjistrin e fermës të krijuar sipas legjislacionit në fuqi për bujqësinë;
- b) regjistrin e blegtorisë, që mbahet në institucionin përgjegjës për veterinarinë deri në datën 30 prill të çdo viti kalendarik, për numrin dhe vendndodhjen e koshereve të bletëve.

2. Të dhënat e regjistrave sipas pikës 1 të këtij neni lidhur me bletarinë pasqyrohen në mënyrë automatike në bazat përkatëse kombëtare të të dhënave.

3. Regjistri i mbretëreshave krijohet dhe mbahet nga qendrat e prodhimit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mbarëshkrimin e blegtorisë. Të dhënat pasqyrohen në regjistrat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Të dhënat e regjistrat do të jenë të aksesueshme nga institucionet e varësisë së ministrisë që lidhen me sektorin e bletarisë.

Neni 6

Raportimi i zgjojeve të bletëve

1. Bletarët njoftojnë vendndodhjen dhe numrin e zgjojeve në institucionin përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve, si dhe ndryshimin e vendndodhjeve të tyre brenda datës 30 prill të çdo viti.

2. Institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve jep informacion periodik të përditësuar për shoqatat lokale të bletërritësve për komunikimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 7

Vendndodhja e parkut të bletëve

1. Parku i bletëve vendoset jo më afër se 10 metra nga rrugët dhe 5 metra nga pronat kufitare.

2. Parku i bletëve është në një vend të përhershëm ose të përkohshëm.

3. Distancat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohen nëse ka diferenca në lartësi më të mëdha se 2 metra midis parkut të bletëve dhe mureve, gardheve ose strehëzave të tjera të përshtatshme, që nuk lejojnë kalimin e bletëve.

4. Parku i bletëve duhet të ruajë distancë 1 kilometër nga strukturat e prodhimit dhe përpunimit të sheqerit industrial.

5. Ndalohet vendosja e parkut të bletëve pranë autostradave, aeroporteve, strukturave të depozitimit dhe përpunimit të metaleve, depozitimit dhe përpunimit të mbetjeve dhe zonave të ndotura.

6. Mënyra e vendosjes së parkut të bletëve, distancat, afërsia me struktura të prodhimit, përpunimit dhe largësia nga zonat e ndotura përcaktohen me urdhër të ministrit.

7. Ndalohen aktivitetet të ndryshme prodhuese industriale në afërsi deri në 3 kilometra të parqeve të cilat ndikojnë në dëmtimin e bletëve.

KREU II

LËVIZJA DHE TRANSPORTI I BLETËVE

Neni 8

Shtegtimi i bletëve

1. Bletarët kryejnë shtegtimin e parkut të bletëve për të shfrytëzuar kullotat dhe prodhimin e llojeve të ndryshme të mjaltit njëlulësh dhe shumëlulësh, pjalmimin e kulturave bujqësore dhe shmangien e kushteve të pafavorshme klimatike.

2. Bletari që kryen shtegtimin paraqet kërkesën në rrugë elektronike në institucionin përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune para datës së shtegtitimit.

3. Bletarët pajisen me certifikatën veterinarë të lëvizjes për gjendjen shëndetësore të bletëve lëshuar nga institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve dhe raportin për masat veterinarë para lëvizjes së parkut të bletëve.

4. Institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve, bazuar në kapacitetet kullimore



sipas programit të miratuar të shfrytëzimit të kullotave, miraton ose refuzon vendosjen e parkut të bletëve.

5. Bletarët pajisen me certifikatë lëvizjeje për shtegtimin e bletëve lëshuar nga institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve dhe zbatojnë detyrat e caktuara nga veterineri zyrtar për masat profilaktike dhe kurative që aplikohen në atë kohë në zonën ku shtegtojnë bletët.

6. Bletarët ruajnë distancën nga parqet e tjera me së paku 50 (pesëdhjetë) metra.

7. Ministri me urdhër miraton modelin e kërkesës për shtegtimin e parkut të bletëve.

Neni 9

Transporti i zgjojeve

1. Transporti i zgjojeve në parkun e bletëve bëhet me mjete transporti të përshtatshme që të garantojë mirëqenien e bletëve në udhëtim.

2. Mjetet e transportit duhet të kenë ventilim.

3. Gjatë transportit është i pranishëm të paktën një bletërritës, i pajisur me veshje dhe pajisjet mbrojtëse.

4. Gjatë transportit inspektimi dhe kontrolli nga institucionet përgjegjëse për veterinarinë nuk mund të jetë më i gjatë se 30 minuta.

5. Kushtet që duhet të plotësojnë mjetet e transportit që transportojnë bletë dhe rregullat për transportimin e tyre përcaktohen me urdhër të ministrit.

KREU III

RIPRODHIMI I BLETËVE DHE KULLOTAT

Neni 10

Riprodhimi i bletëve, importi dhe tregtimi i mbretëreshave dhe i familjeve të bletëve

1. Përzgjedhja e bletëve bëhet nga lloji i bletës europiane *apis mellifera* dhe nënlojet lokale të bletëve për riprodhim: *apis mellifera carnica* në vendet e Ballkanit, *apis mellifera ligustica*, *apis mellifera sicula*, *apis mellifera cecropia*, *apis mellifera mellifera*, *apis mellifera macedonica*, *apis mellifera caucasica*. Lloje të tjera përcaktohen me urdhër të ministrit pas propozimit të autoritetit kompetent për veterinarinë.

2. Për përzgjedhjen e llojit, bletari duhet të vlerësojë përshtatjen e llojit me kushtet lokale

klimatike dhe rezistencën ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

3. Importi dhe tregtimi i mbretëreshave dhe i familjeve të bletëve bëhet vetëm nga subjektet e regjistruara dhe të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për importin e kafshëve të gjalla dhe i nënshtrohet kontrollit sipas përcaktimeve në këtë legjislacion.

4. Tregtimi i familjeve të bletëve bëhet vetëm shoqëruar me certifikatë lëvizjeje lëshuar nga institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve.

5. Familjet e bletëve krijohen me shumim të familjeve ekzistuese të bletëve.

6. Qendrat riprodhuese për mbretëresha të bletëve, riprodhimi dhe tregtimi duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës për mbarështimin e blegtorisë.

Neni 11

Burimet e nektarit, administrimi i kullotave të bletëve

1. Nektari, mjalti, poleni dhe propolisi janë prodhime të një cikli natyror me interes publik.

2. Për qëllime të shfrytëzimit të përshtatshëm të prodhimit të nektarit, nxitet mbarështimi i bletëve dhe praktika ekonomiko-prodhuese e shtegtimin.

3. Administrimi i burimeve të nektarit dhe kullotave të bletëve bëhet përmes programit të shfrytëzimit të kullotave, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mbarështimin e blegtorisë. Programi i monitorimit dhe parashikimi i kapacitetit nektaror dhe pjalmi hartohet dhe miratohet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mbarështimin e blegtorisë.

4. Struktura përgjegjëse në ministri mban regjistrin për shfrytëzimin e kullotave mjaltëdhënëse. Regjistri i kullotave përbën bazë të dhënash me informacion për identifikimin, kapacitetin dhe llojet e kullotave, si dhe me parashikim të kapacitetit nektaror e pjalmi në rritjen e bletëve.

5. Kushtet e hollësishme për mbajtjen e regjistrin të kullotave mjaltëdhënëse për mbarështimin e tyre, për lëvizjen e parqeve të bletëve në kullota, programi i parashikimit të kapacitetit nektaror dhe pjalmi, si dhe programi i shfrytëzimit përcaktohen me rregullore, e cila miratohet me urdhër të



ministrit pas konsultimit me shoqatat lokale të bletërritësve.

KREU IV MBROJTJA E BLETËVE

Neni 12 Mbrojta e bletëve

1. Bletari duhet të ketë njohuri bazë mbi bletarinë, që lidhen me rregullat e sigurimit teknik, të sjelljes me kolonitë e bletëve, vendosjes së tyre në territor, bazat e mbarështimit e të mjekimit.

2. Bletari është i detyruar që në parkun e vet të bletëve të ndërmarrë të gjitha masat për parandalimin, luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjeve, duke përdorur vetëm produktet mjekësore veterinarë, të regjistruara dhe në sasinë e rekomanduar nga mjeku veterinar.

3. Bletari mban regjistër për trajtimet mjekësore që kryen.

4. Masat profilaktike dhe luftimi i sëmundjeve të bletëve përcaktohen në fillim të çdo viti kalendarik për vitin vijues nga institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve, në bashkëpunim me ekspertët e fushës, sipas legjislacionit në fuqi për veterinarinë.

5. Çdo bletar në rastin e dyshimit të paraqitjes së sëmundjeve me karakter përhapës, siç janë: nozematoza, varroatoza, akarapidoza, pesta amerikane, pesta europiane, aetinoza, tropilaelaps spp, dëmtimeve të paidentifikuara ose helmimeve, si dhe sëmundjeve të tjera që bëjnë pjesë në listën e sëmundjeve detyrimisht të raportueshme, lajmëron menjëherë inspektorin veterinar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për veterinarinë.

6. Shoqatat lokale të bletërritësve raportojnë çdo rast të dyshuar ose të diagnostikuar për praninë e sëmundjeve në strukturën përgjegjëse për kontrollet zyrtare sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për veterinarinë.

7. Ndalohet trajtimi me produkte mjekësore veterinarë i bletëve, të cilat nuk e kanë lejen për përdorim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për veterinarinë.

8. Ndalohet përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe materialeve të tjera, të cilat përmes produkteve të bletës mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut.

9. Për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore, si: djegie, përmytje, dëmtime nga kafshët e egra, bletarët mund të bëjnë sigurimin vullnetar të aseteve të tyre përmes njoftimeve, programeve, platformave të ndryshme që janë në funksion të tyre nga ministria.

Neni 13 Programi për zhvillimin e bletarisë

1. Ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe ministria përgjegjëse për pyjet, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe prodhimeve agropjore, hartojnë programin 3-vjeçar për zhvillimin e bletarisë, për bashkërendimin e aktiviteteve të sektorit në bashkëpunim me shoqatat e fermerëve, shoqatat e bletërritësve, Federatën e Bletërritësve, organizatave të mbrojtjes së konsumatorit dhe grupeve të tjera të interesit.

2. Programi përmban:

a) promovimin dhe mbrojtjen e produkteve shqiptare të bletëve dhe nxitjen e proceseve të gjurmueshmërisë sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tyre;

b) zgjerimin e produkteve me emërtim origjinë të mbrojtur, tregues gjeografik të mbrojtur, specialitet tradicional të garantuar, si dhe produkt biologjik sipas legjislacionit në fuqi;

c) mbështetjen për bletërritësit, informacion për shoqatën lokale të bletërritësve, nxitjen e anëtarësimit, promovimin e marrëveshjeve profesionale me shoqata të tjera, organizma publikë dhe privatë që operojnë në këtë sektor;

ç) zhvillimin e programeve të kërkimit e të eksperimentimit të bletarisë në marrëveshje me shoqatat e bletërritësve, universitetet etj.;

d) integrimin midis bletarisë dhe bujqësisë;

dh) vlerësimet e përgjithshme mbi kufijtë dhe ndalimet të cilave mund t'i nënshtrohen trajtimet me pesticide me produkte fitosanitare dhe herbicide toksike për bletët në kulturat e pemëve, barishtore, zbukuruese, të kultivuara dhe spontane gjatë periudhës së lulëzimit;

e) përcaktimin e kufijve dhe ndalimeve për përdorimin e kulturave/bimëve mjaltëdhënëse që rrjedhin nga organizma të modifikuar gjenetikisht;

ë) nxitjen e praktikës së pjalmimit me anë të bletëve;

f) nxitjen e praktikës së bletarisë dhe shtegimit të bletëve;



g) mbrojtjen dhe mbjelljen e kulturave të reja të bimëve mjaltëdhënëse, polendhënëse apo nektaropolenike sipas biodiversitetit;

gj) përcaktimin e ndërhyrjeve të rimëkëmbjes ekonomike dhe të kontrollit për luftën kundër varrotozës dhe sëmundjeve të tjera të bletëve;

h) forcimin dhe zbatimin e kontroleve mbi produktet e bletëve me origjinë kombëtare nga vendet e Bashkimit Europian dhe vende të tjera;

i) stimuj për të rinjtë për t'u vendosur dhe qëndruar në sektorin e bletarisë;

j) sigurimin e mbështetjes për bletarët që operojnë në zona malore ose të pafavorizuara;

k) mbrojtjen dhe përzgjedhjen e bletës së pastër shqiptare (*apis mellifera carnica*) dhe racave të tjera të vendeve fqinje që janë përshtatur me kushtet e vendit tonë, sipas përcaktimeve të nenit 10 të këtij ligji, si dhe nxitjen e prodhimit të mbretëreshave shqiptare nga qendrat e seleksionimit gjenetik.

3. Programi miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për pyjet.

Neni 14

Kualifikimi i bletarëve

1. Kushdo që ushtron veprimtarinë e bletarisë mund të ndjekë kurse kualifikimi, të cilat në varësi të aktivitetit që do të ndërmarrë përbëhen nga dy module: moduli bazë me rregullat e sigurimit teknik të sjelljes me kolonitë e bletëve, vendosjes së tyre në territor, bazat e mbarështimit e të mjekimit, si dhe moduli i avancuar për bletarë profesionistë.

2. Modulet sipas pikës 1 të këtij neni duhet të hartohen dhe të ofrohen nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, si dhe të miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

3. Shoqatat lokale të bletërritësve kryejnë trajnimin e bletarëve amatorë dhe profesionistë.

Neni 15

Asgjësimi i bletëve

1. Asgjësimi i bletëve bëhet vetëm në rastet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për veterinarinë.

2. Asgjësimi bëhet në prezencë të inspektorëve veterinarë të institucionit përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve, zooteknikëve të institucionit përgjegjës për ekstension bujqësor, si

dhe mund të ketë përfaqësues të Shoqatës Lokale të Bletërritësve.

3. Dëmshtëpërblimi i dëmeve për asgjësimin e bletëve kryhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për veterinarinë.

Neni 16

Mbrojtja e bletëve nga përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve

1. Gjatë spërkatjes së bimëve, në periudhën e lulëzimit bletarët lajmërohen nga përdoruesit e PMB-ve 3 (tri) ditë para përdorimit dhe marrin masat e nevojshme për të mbyllur dyert e zgjojeve ose duke larguar parkun e bletëve së paku 6 km larg në vijë ajrore nga zona e spërkatjes.

2. Nëse bletari nuk i ndërmerr masat e përshtatshme sipas pikës 1 të këtij neni, humb të drejtën për të kërkuar dëmshtëpërblim.

Neni 17

Mbrojtja e racës autoktone të bletëve

1. Mbrojtje e veçantë përcaktohet për racën vendase të bletëve *apis mellifera carnica*, ku nxiten bletarët dhe institucionet e ndërlidhura të informojnë bletarët për përzgjedhjen e racës vendase, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mbarështimin e blegtorisë.

2. Për përzgjedhjen e llojeve të tjera të bletëve, bletari duhet të marrë në konsideratë përshtatjen e llojit, sipas përcaktimeve të nenit 11 të këtij ligji, ndaj kushteve lokale dhe rezistencën ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve, por gjithmonë duke marrë miratim nga ministria sipas legjislacionit në fuqi për futjen e racave të reja në Republikën e Shqipërisë.

KREU V

BLETARIA CILËSORE

Neni 18

Bletaria biologjike

Prodhimi biologjik i produkteve të bletës kryhet sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre.



Neni 19

Skemat e cilësisë për produktet e bletëve

Për produktet e bletëve të prodhuara në vend, për të shtuar vlerën dhe garantuar mbrojtjen e tyre, me emërtim origjine të mbrojtur, tregues gjeografik të mbrojtur dhe specialitet tradicional të garantuar, fermerët, shoqatat, grupet e prodhuesve, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor aplikojnë për skemat e cilësisë sipas legjislacionit në fuqi për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore.

Neni 20

Etiketimi i produkteve të bletës

1. Etiketimi i produkteve të bletëve bëhet në përputhje me legjislacionin për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit, si edhe rregulloret përkatëse të produkteve.

2. Elementet e etiketës janë:

- a) emri ose emri tregtar dhe adresa e operatorit të biznesit ushqimor;
- b) lista e përbërësve;
- c) sasia e përbërësve ose e kategorive të caktuara të përbërësve sipas rendit zbritës;
- ç) sasia neto e produktit ushqimor;
- d) data e jetëgjatësisë minimale ose shprehja “të përdoret përpara datës” dhe në rastin e mjaltit të vendoset shprehja “për një periudhë 24-mujore nga data e prodhimit”;
- dh) kushtet e veçanta të ruajtjes dhe/ose kushtet e përdorimit;
- e) shteti i origjinës ose vendi i prejardhjes, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ë) udhëzimet e përdorimit kur në mungesë të tyre përdorimi i duhur i produktit ushqimor do të ishte i vështirë;
- f) deklarata e vlerave ushqyese;
- g) përshkrimi për mjaltin “Nuk rekomandohet për fëmijët nën 1-vjeç”.

3. Në rast të importit të mjaltit ose produkteve të tij, përveç elementeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, etiketa duhet të përmbajë edhe përcaktimin që është produkt importi, shtetin nga vjen, si dhe duhet të jetë në gjuhën shqipe.

KREU VI

PJALMIMI, BLETARIA URBANE DHE USHQYERJA

Neni 21

Pjalmimi natyral

1. Ministria dhe shoqatat lokale të bletërritësve kryejnë promovim të aktivitetit të pjalmimit natyral, pasi:

a) njihet si veprimtari bujqësore, thelbësore për mbijetesën e njeriut dhe ndihmon në lehtësimin e prodhimit të ushqimit;

b) bletët janë pjalmuese efikase dhe të besueshme. Ato janë mbledhëse metodike të nektarit dhe polenit, nuk e shkatërrojnë bimën dhe ruajnë biodiversitetin dhe produktivitetin e ekosistemeve natyrore dhe bujqësore;

c) bletët pjalmojnë mbi 80% të bimëve të lulëzuara të tokës, duke përfshirë pothuajse të gjitha frutat dhe perimet.

2. Ministria dhe shoqatat lokale të bletërritësve nxisin ndërgjegjësimin për nevojën për të mbrojtur bletët përmes njoftimeve, trajnimeve, platformave, si dhe hartimit të planeve të ndërgjegjësimit e të promovimit, pasi rënia e numrit të tyre mund të ketë një ndikim të paparashikueshëm në ekosistemet e tokës.

3. Bletarët lejohen të blejnë, të transportojnë dhe të mbajnë sheqer dhe substanca të sheqerosura thelbësore për ushqimin e familjeve të bletëve, me detyrimin e mbajtjes së shënimeve të ngarkimit dhe shkarkimit të substancave me sheqer.

Neni 22

Bletaria urbane

Mbajtja e bletëve mbi tarracat e pallateve në zonat urbane rregullohet nga organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore me marrëveshje me Shoqatën Lokale të Bletërritësve, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e monitorimit të mjedisit.

Neni 23

Ushqyerja e bletëve

1. Ushqyerja e bletëve me sherbet/sheqer apo shurupe të tjera nuk duhet të bëhet gjatë periudhës së lulëzimit kryesor të bimëve mjaltëdhënëse dhe mbledhjes së nektarit nga bletët.



2. Ushqyerja me sherbet/sheqer apo shurupe të tjera është e lejueshme gjatë lulëzimit të bimëve mjaltëdhënëse vetëm në rastet e reshjeve të zgjatura të shiut (për disa ditë me radhë, që nuk lejojnë daljen e bletës për të grumbulluar nektar) dhe me njoftimin paraprak të veterinerit zyrtar (ku të deklarohet sheqeri i përdorur dhe sasia e përdorur dhe të gjitha veprimet të jenë të pasqyruara në regjistrin e bletarit, me datën përkatëse).

3. Ushqimet e tjera të përdorura për të ushqyer bletët me bazë proteinike apo sheqerore si *candy*, pogaçe etj. duhet të jenë të prodhuara vetëm nga stabilimente të licencuara dhe të kontrolluara nga autoritetet përkatëse të kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

4. Çdo ushqim i përdorur që është i pakontrolluar mund të sjellë kontaminimin e paqëllimshëm të produkteve të bletës, si: mjaltit, qumështit të bletës etj., dhe shkakton prodhimin e produkteve të bletës jo në përputhje me kriteret e cilësisë.

KREU VII

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE DHE MBËSHËTËTJA E SEKTORIT TË BLETARISË

Neni 24

Institucionet përgjegjëse

1. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë:

- a) struktura përgjegjëse në ministri;
- b) institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve;
- c) institucioni i kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë;
- ç) njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni ushtrojnë detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat në zbatim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe dispozitave të këtij ligji.

Neni 25

Mbështetja e sektorit të bletarisë

Mbështetja e sektorit të bletarisë bëhet bazuar në politikat e ministrisë përmes programeve dhe masave të ndryshme të mbështetjes.

KREU VIII

PËRPUNIMI DHE RUAJTJA E MJALTTIT

Neni 26

Ambientet, mjetet për përpunimin dhe kushtet e magazinimit

1. Fermeri, personi fizik/juridik, që kryen procesin e përpunimit dhe ruajtjes së mjaltit, duhet të zotërojë mjetet e mëposhtme:

- a) për pranim, vjelje dhe mirëmbajtje të ambalazhit;
- b) për përpunim, mbushje dhe paketim;
- c) për prodhimet e paketuara;
- ç) për infrastrukturën.

2. Ambientet e përpunimit dhe ruajtjes duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

Neni 27

Kushtet e ruajtjes

Mjalti duhet të ruhet në vende të thata, të errëta, në temperaturë më të ulët se 25°C dhe lagështi relative të ajrit nga 65% deri në 80%.

Neni 28

Mbikëqyrja

Mbikëqyrja kryhet nga inspektorët e veterinarisë e të blegtorisë, sipas përcaktimeve ligjore për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve.

KREU IX

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, MASAT DHE EKZEKUTIMI

Neni 29

Kundërvajtjet administrative

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

- a) ushtrimi i veprimtarisë në kundërshtim me nenin 5 të këtij ligji;
- b) vendosja e parkut të bletëve pa ruajtur distancat, në kundërshtim me nenin 7 të këtij ligji;
- c) shtegtimi i bletëve pa miratimin e institucionit përgjegjës sipas parashikimit të nenin 8 të këtij ligji.



ç) mosnjoftimi i institucionit përgjegjës në rast dyshimi të sëmundjeve sipas parashikimit të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 30

Masat administrative

Për kundërvajtjet e parashikuara në nenin 29 të këtij ligji merren masat administrative si më poshtë:

a) për shkeljet e parashikuara në shkronjën “a”, për bletarët amatorë gjobë nga 2 000 lekë deri në 5 000 lekë, ndërsa për bletarët profesionistë nga 5 000 lekë deri në 20 000 lekë.

b) për shkeljet e parashikuara në shkronjën “b”, për bletarët amatorë gjobë nga 2 000 lekë deri në 5 000 lekë, ndërsa për bletarët profesionistë nga 5 000 lekë deri në 30 000 lekë.

c) për shkeljet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç”, për bletarët amatorë gjobë nga 2 000 lekë deri në 5 000 lekë, ndërsa për bletarët profesionistë nga 10 000 lekë deri në 40 000 lekë.

Neni 31

Procedura e kundërvajtjes administrative

1. Institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve brenda fushës së tij të përgjegjesisë merr masat administrative sipas këtij ligji.

2. Institucioni i kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë brenda fushës së tij të përgjegjesisë merr masa administrative për shkeljet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

3. Kundër vendimit për marrjen e masave administrative sipas neneve 29 dhe 30 të këtij ligji, bëhet ankim në komisionin për shqyrtimin e masave administrative të veterinerit zyrtar në ministri dhe në gjykatë sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 32

Ekzekutimi i vendimit

Ekzekutimi i vendimeve bëhet në formën dhe parashikimet e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 33

Të ardhurat nga vjelja e gjobave

Të ardhurat që krijohen nga arkëtimi i gjobave derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

KREU X

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Bletarët profesionistë raportojnë në institucionin përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve vendndodhjen e kolonive të bletëve dhe numrin e koshereve brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 35

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet ministri që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 6; nenit 8, pika 7; nenit 9, pika 5; nenit 10, pika 1, dhe nenit 11, pika 5, të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për pyjet që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 13, pika 3, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për arsimin që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 14, pika 2, të këtij ligji.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 maj 2024.

Miraturar më datë 16.3.2023.

Shpallur me dekretin nr. 49, datë 3.4.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

**DEKRET**

Nr. 49, datë 3.4.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 20/2023, “Për bletarinë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 21/2023

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 8378, DATË 22.7.1998
“KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e disa deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, pika 6, shkronja “B” ndryshohet si më poshtë:

“B – Qarku, kur lidhin kryeqendrën e qarkut me bashkitë, qendrat e njësive administrative dhe zonat e tjera me interes industrial, bujqësor, turistik e klimaterik, rrugët që lidhin qendrat e njësive administrative, bashkitë me qendrat e njësive administrative dhe rrugët që lidhen qendrat e bashkisë dhe të njësive administrative me rrugët shtetërore.”.

Neni 2

Kudo në përmbajtjen e Kodit:

- emërtimi “Ministritë së Rendit Publik” zëvendësohet me emërtimin “Ministritë së Brendshme”;
- emërtimi “Ministritë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohet me fjalët “ministritë përgjegjëse për çështjet e kulturës”;
- emërtimi “Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve” zëvendësohet me emërtimin “Autoritetit Rrugor Shqiptar”;
- fjala “rrethit” zëvendësohet me fjalën “qarkut”.

Neni 3

Në nenin 7 bëhen shtesat e mëposhtme:

- a) në pikën 1, shkronja “f”, shtohet fjalia “Zonat e destinuarat për parkim përkundrejt pagesës nuk mund të jenë më shumë se 50 për qind e zonave ose rrugëve të destinuarat për parkim në total brenda territorit të bashkisë.”;
- b) në pikën 8, shkronja “c”, paragrafi i gjashtë, pas fjalisë së parë shtohen fjalitë “Zonat e destinuarat për parkim pa pagesë duhet të jenë jo më të vogla se sipërfaqja e zonave të destinuarat për parkim me pagesë. Në varësi të kushteve dhe rrethanave objektive, bashkitë marrin masa për të garantuar zona parkimi pa pagesë për të gjithë banorët rezidentë pranë banesës së tyre.”.

Neni 4

Në nenin 12 pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Kontrolli i mjeteve në rrugët interurbane, kryerja e shërbimeve sipas nenit 11, pika 1, shkronja “a”, të këtij Kodi konsiston vetëm në identifikimin e shkeljeve me pajisje teknologjike dhe vetëm në ndalimin e shoqërimit të mjetit në një pikë kontrolli me kushte sigurie.”.

Neni 5

Në nenin 79 në pikën 3 pas fjalës “taksi” shtohet fjala “, autoshkolla”.



Neni 6

Në nenin 86 në pikën 6 fjalë e fundit shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 98 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot që qarkullojnë për qëllime verifikimi dhe kontrolli të përshtatshmërisë teknike, për të shkuar në pikat tranzit të kufirit për t'u eksportuar, për të marrë pjesë në parada të parashikuara nga autoritetet ushtarake, në panaire apo ekspozita të autorizuar për mjete të reja ose të përdorura për të cilat nuk është paguar taksa e regjistrimit, duhet të pajisen me fletudhëtimi dhe targa të përkohshme, të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.

Neni 8

Në nenin 114 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Cilido që drejton mjete me motor, nuk duhet të ketë kaluar moshën shtatëdhjetë vjeç për të drejtuar autobusë, kamionë, kamionë me rimorkio, gjysmërimorkiatorë, artikulare të tjerë, të caktuar për transport personash dhe mjete me motor për transport malli.”.

Neni 9

Në nenin 117/1 bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Kufizime për drejtuesit e mjeteve rrugore”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Mbjatësve të lejeve të drejtimit të kategorisë B, në dy vjetët e para të lëshimit, nuk u lejohet të drejtojnë mjete motorike me fuqi specifike, referuar masës bosh të mjetit, më të madhe se 55 kw/tonë. Për makinat hibride elektrike ose *plug-in*, kufiri specifik i fuqisë është 65 kw/tonë, duke përfshirë peshën e baterisë.

Kjo pikë zbatohet vetëm për lejet e drejtimit që lëshohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.”.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor përcaktohen modalitetet e shënimit në lejen e

qarkullimit të kufizimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni.”.

Neni 10

Në nenin 120 në pikën 2 fjalët “65 vjeç” zëvendësohen me fjalët “70 vjeç”.

Neni 11

Në nenin 121 pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Trajnimi për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti kryhet pranë çdo autoshkolle sipas përcaktimeve në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”.

Neni 12

Në nenin 124 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pikat 1, 2, 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

“1. Lejedrejtimit e mjeteve të kategorive AM, A1, A2, A, B1, B dhe BE sipas grup-moshave janë të vlefshme për:

- 15 vjet nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri në moshën 70 vjeç;

- për personat mbi 70 vjeç konfirmimi i vlefshmërisë së lejes së drejtimit bëhet duke dorëzuar certifikatë mjekësore të lëshuar nga një prej organeve mjekësore të parashikuara në pikën 2 të nenit 117 të këtij Kodi, nga e cila të rezultojë që zotëruesi i kësaj certifikate plotëson të gjitha kërkesat fizike e psikike të kërkuara.

2. Lejedrejtimit e mjeteve të kategorive C1, C1E, C, CE, D1, D1E, D dhe DE sipas grup-moshave janë të vlefshme për:

- 5 vjet nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri në moshën 70 vjeç;

Sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 114 të këtij Kodi për personat mbi 65 vjeç, lejedrejtimi e kategorive C dhe CE lëshohet për drejtimin e mjeteve, masa e përgjithshme e të cilave me ngarkesë të plotë nuk është më shumë se 20 tonë.

Sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 114 të këtij Kodi për personat mbi 65 vjeç, lejedrejtimi e kategorive D1 ose D, apo D1E ose DE lëshohet vetëm për drejtimin e mjeteve për të cilat kërkohet pajisja me lejedrejtimi përkatësisht të kategorisë B ose BE.



4. Lejedrejtimet e posaçme të mjeteve, lëshuar për personat me aftësi të kufizuara, të kategorive AM, A1, A2, A, B1, B dhe BE, janë të vlefshme për:

- 5 vjet nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri në moshën 65 vjeç;
- 3 vjet për persona mbi 65 vjeç.

5. Lejedrejtimet e posaçme të mjeteve, lëshuar për personat me aftësi të kufizuara, të kategorive C1, C1E, C dhe CE janë të vlefshme për:

- 5 vjet nëse janë lëshuar apo konfirmuar për persona deri në moshën 65 vjeç:

Këto leje nuk rinovohen pas moshës 65 vjeç.”.

b) Pikat 3 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 13

Në nenin 127 në fund të pikës 3.1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“I njëjti rregull aplikohet edhe për lejet e drejtimit të lëshuara nga shteti shqiptar në rastin kur kundërvajtësi jep pëlqimin.”.

Neni 14

Në nenin 128 në fund të pikës 2 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në rastet e anulimit sipas pikës 1, shkronja “d”, të këtij neni kur nuk ekzistojnë më motivet, i interesuari mund të procedojë drejtpërsëdrejti për të marrë lejedrejtimin e një kategorie jo më të lartë sesa ajo që i është anuluar, me anë të një kërkesë, dorëzimit të lejedrejtitimit të shtetit tjetër dhe verifikimit të kërkesave fizike e psikike të parashikuara për konfirmimin e vlefshmërisë së lejedrejtitimit që kërkon i interesuari.”.

Neni 15

Në nenin 132 në pikën 1 shprehja “15-ditore” zëvendësohet me shprehjen “30-ditore”.

Neni 16

Në nenin 140 në pikën 1 fjalët “110 km/orë për autostradat” zëvendësohen me fjalët “130 km/orë për autostradat”.

Neni 17

Në nenin 169 pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Drejtuesi i motomjeteve është i detyruar të bëhet i dallueshëm në rrugët interurbane nga gjysmë ore pas përfundimit të diellit deri gjysmë ore përpara lindjes së tij, si dhe ditën në raste mjegulle, kur ka borë, ka shira të fortë. Për ta bërë këtë, drejtuesi i motomjetit është i detyruar të përdorë jelek fluoreshent/fosforeshent të homologuar apo veshje teknike me elemente fosforeshente. Kushdo që nuk zbaton këtë detyrim, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga 1000 (një mijë) deri në 3 (tre mijë) lekë.”

Neni 18

Në nenin 170 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Drejtuesi i mjetit dhe pasagjerët e mjeteve të kategorisë L6, të pajisura me kabinë të mbyllur dhe të automjeteve të kategorive M1, M2, M3 dhe N1, N2, N3 sipas klasifikimit të nenit 47, pika 2, të këtij Kodi, të pajisura me rripa sigurie, janë të detyruar t'i vendosin ato në çdo lloj lëvizjeje me mjet. Bëjnë përjashtim mjetet e kategorive M2 dhe M3, të cilat përdoren për transport urban ose ato mjete ku lejohet qëndrimi në këmbë.”

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Fëmijët deri në moshën 3 vjeç duhet të udhëtojnë të siguar me sisteme të përshtatshme fiksuese të homologuara, të përshtatshme për peshën e tyre, në vendet e pasme të mjetit.

Ata mund të udhëtojnë në vendet e përparme të mjeteve të kategorive M1, N1, N2 dhe N3 të klasifikuara në nenin 47, pika 2, të këtij Kodi, të siguar me sisteme të përshtatshme fiksuese, me fytyrë prapa, vetëm kur jastëkët e ajrit janë të çaktivizuar.

Sistemet fiksuese të fëmijëve duhet të instalohen në mjet në përputhje me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi.”.

c) Pas pikës 4 shtohen pika 4/1 dhe 4/2 me këtë përmbajtje:

“4/1. Në mjetet e kategorive M1, N1, N2 dhe N3 pa sisteme të përshtatshme fiksuese fëmijët me moshë deri në tre vjeç nuk mund të udhëtojnë.



4/2. Fëmijët me moshë mbi tre vjeç nuk lejohet të qëndrojnë në vendet e përparme kur gjatësia e tyre nuk kalon 1,50 m.”.

ç) Në pikat 5 dhe 6 fjalët “në moshën 4 vjeç” zëvendësohen me fjalët “në moshën 3 vjeç”.

d) Në pikën 8 paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Cilido që nuk përdor rripat e sigurisë dhe sistemet e fiksimit për fëmijë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga 5000 (pesë mijë) deri në 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë. Kur shkelja i takon një fëmije në moshë jomadnore, përgjegjësia bie mbi drejtuesin e mjetit ose, kur ndodhet në çastin e kryerjes së shkeljes, mbi atë që është ngarkuar me mbikëqyrjen e këtij fëmije. Në rast se është drejtuesi i mjetit, përveç masës administrative të ndëshkimit me gjobë, merret edhe masa administrative plotësuese e pezullimit të lejdrejtimit për një periudhë nga 6 deri në 12 muaj.”.

Neni 19

Në nenin 200 fjalët “me një shumë deri në pesë mijë lekë” hiqen.

Neni 20

Në nenin 203 pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Të ardhurat nga masat administrative me gjobë për shkeljet e parashikuara nga nenet e këtij Kodi paguhen nga kundërvajtësi brenda 15 ditëve nga dita që gjoba regjistrohet ose vendimi ka marrë formën e prerë me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon gjobë në vend. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet 2 për qind kamatë deri në një muaj. Kur gjoba nuk paguhet ose nuk nxirret dot nga të ardhurat e shkelësit, për rastet e drejtuesit të mjetit me motor, bëhet ndalimi i mjetit deri në tre muaj dhe pas këtij afati bëhet shitja e mjetit me ankand, duke i dhënë diferencën në lekë shkelësit.

2. Në të gjitha rastet e parashikuara me gjobë, nëse arkëtimi i vlerës së gjobës nga kundërvajtësi bëhet brenda 15 ditëve nga dita që gjoba regjistrohet ose vendimi ka marrë formë të prerë, gjoba ulet me 50 për qind të vlerës.”.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 16.3.2023.

Shpallur me dekretin nr. 50, datë 3.4.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 50, datë 3.4.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 21/2023, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, ‘Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 22/2023

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
MAQEDONISË SË VERIUT PËR
KRIJIMIN E TASK-FORCAVE TË
PËRBASHKËTA NË FUSHËN E
SIGURISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Maqedonisë së Veriut për krijimin e task-forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.3.2023.

Shpallur me dekretin nr. 47, datë 31.3.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJENDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKË SË
MAQEDONISË SË VERIUT PËR KRIJIMIN E
TASK-FORCAVE TË PËRBASHKËTA NË
FUSHËN E SIGURISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Maqedonisë së Veriut (në vijim të referuara si “Palë”),

me dëshirën e përbashkët për të punuar në mposhtjen e kërcënimeve të sigurisë dhe luftën efektive kundër krimit të organizuar ndërkombëtar përmes partneritetit dhe përmes aktiviteteve të koordinuara;

duke njohur bashkëpunimin e mirë, të bazuar në besimin e ndërsjellë policor në luftën kundër krimit;

zbatimin e rregulloreve efektive të legjislationit kombëtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Republikën e Shqipërisë;

për zgjidhjen e çështjeve që lindin gjatë bashkëpunimit të ndërsjelle, si dhe marrjen e vendimeve për të vepruar,

kanë rënë dakord si në vijim.

Neni 1

Autoritetet kompetente

Autoritetet kompetente të Palëve për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të jenë:

- Për palën shqiptare: Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

- Për palën maqedonase: Ministria e Punëve të Brendshme, Byroja për Siguri Publike.

Neni 2

Task-forcat e përbashkëta

1. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të krijohen task-forca të përbashkëta (referuar në vijim si “Task-Forcë”), të cilat do të përbëhen nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve.

2. Autoritetet kompetente të Palëve do të njoftojnë njëra-tjetrën në kohën e duhur për numrin dhe përbërjen e anëtarëve të Task-Forcave.

Neni 3

Emërimi i koordinatorëve

1. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve do të caktojnë koordinatorë (referuar në vijim si “Koordinatorët”), të cilët do të menaxhojnë Task-Format dhe do të organizojnë ekzekutimin e detyrave të tyre.

2. Autoritetet kompetente të Palëve do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë për emërimin e koordinatorëve të përmendur në këtë nen.

Neni 4

Objektivat e marrëveshjes

Objektivi i kësaj marrëveshjeje do të jetë krijimi i bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve dhe Task-Forcave të tyre, për të shqyrtuar taktikat, përgatitjet dhe kohën për zgjidhjen e çështjeve që dalin gjatë bashkëpunimit të ndërsjelle, si dhe për të vendosur kur dhe si të ndërmerren veprime në territoret e shteteve Palë, veçanërisht duke shkëmbyer informacione për raste të veçanta bashkëpunimi.



Neni 5

Fushat e bashkëpunimit

Autoritetet kompetente dhe Task-Forcat e tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar, do të bashkëpunojnë në bazë të kësaj Marrëveshjeje, duke shkëmbyer informacione, veçanërisht për veprat penale për të cilat rrethanat kërkojnë veprime të koordinuara, të sinkronizuara dhe, në veçanti:

a) mbi të dyshuarit ose autorët, mënyrën e kryerjes së krimeve, kohën, vendin dhe masat e ndërmarra për parandalimin e veprave penale, autorit dhe bashkëpunëtorit e tyre;

b) mbi përvojat që i referohen shfaqjes së llojeve të reja të krimit; mbi operacionet ose aktet e ardhshme dhe rreziqet e mundshme të sigurisë;

c) mbi dispozitat ligjore dhe rregulloret e brendshme dhe çdo ndryshim të tyre, në lidhje me këtë Marrëveshje;

d) gjatë ndjekjes së personave të dyshuar për kryerjen e krimeve dhe personave që i shmangen përgjegjësisë penale;

e) gjatë ndjekjes së personave, si në lidhje me vepra penale, ashtu edhe jo, por edhe gjatë kryerjes së veprimeve, me qëllim identifikimin e personave;

f) mbi rezultatet e hetimeve penale për veprat penale, teknikat e hetimit dhe aplikimin e metodave dhe mjeteve për zhvillimin e mëtejshëm të tyre;

g) mbi rezultatet e ekspertizës mjekoligjore për rastet e ndërmarra.

Neni 6

Bashkëpunimi sipas kërkesës

1. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve do të kryhet përmes kërkesës për ndihmë, për eliminimin e rreziqeve për rendin dhe sigurinë publike, me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e krimeve, nëse kërkesa ose veprimi është në përputhje me ligjin kombëtar të shteteve Palë dhe nuk është në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore.

2. Kërkesat u dërgohen drejtpërdrejte autoriteteve kompetente.

3. Sipas ligjit kombëtar, kërkesa e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni mund të lidhet me:

a) identifikimin e pronarëve dhe të personave që përdorin mjetet e transportit;

b) kontrollet në lidhje me dokumentet publike dhe dokumentet tjera të ndërlidhura;

c) përcaktimi i rezidencës ose i vendbanimit;

d) identifikimin e pronarëve dhe të përdoruesve të numrave të telefonit ose mjeteve të tjera të komunikimit;

e) përcaktimi i identitetit të personave;

f) përcaktimi i prejardhjes së sendeve me të cilat është kryer krimi ose që burojnë nga krimi i kryer;

g) mbledhja e informacionit të nevojshëm;

h) arsye të tjera që do të përcaktohen nga autoritetet kompetente dhe nuk do të përjashtojnë bashkëpunimin e parashikuar në këtë Marrëveshje.

4. Si rregull, kërkesat, si dhe përgjigjet përkatëse për to, bëhen me shkrim. Në raste të veçanta dhe urgjente, koordinatorit mund t'i bëhet edhe kërkesë në formë gojore dhe sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 24 orë pas bërjes së kësaj kërkesë në këtë mënyrë, duhet të dorëzohet një kërkesë me shkrim.

Neni 7

Shkëmbimi i të dhënave personale dhe i informacionit të klasifikuar

1. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve, gjatë shkëmbimit të informacionit duhet të përpunojnë të dhënat personale në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës, duke respektuar kushtet e përcaktuara nga autoriteti dërgues dhe duke ndjekur parimet e zbatueshme për përpunimin automatik dhe joautomatik të të dhënave.

Autoritetet Kompetente të palëve duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Në veçanti, garantojnë se vetëm palët e autorizuara për akses në të dhënat personale mund të kenë akses në këto të dhëna. Në veçanti, do të zbatohen parimet e mëposhtme:

a) të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe ligjore;

b) të dhënat personale duhet të mbledhen për qëllimin specifik, të qartë dhe legjitim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk duhet të përpunohen



nga autoriteti paraqitës, as nga autoriteti marrës, në një mënyrë të papajtueshme me këtë qëllim;

c) të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe nuk duhet të tejkalojnë qëllimin për të cilat janë mbledhur dhe/ose përpunuar, në veçanti, të dhënat personale të specifikuar në kërkesën për posedim;

d) të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe kur është e nevojshme, të përditësuara; të dhënat personale duhet të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave personale, jo më gjatë se sa është e nevojshme dhe për qëllimet për të cilat të dhënat janë mbledhur ose për të cilat ato janë përpunuar;

e) autoriteti paraqitës dhe autoriteti marrës do të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar korrigjimin, fshirjen ose bllokimin e të dhënave personale, si të përshtatshme, kur përpunimi i tyre nuk është në përputhje me dispozitat e këtij nënparagrafi, veçanërisht kur këto të dhëna nuk janë të përshtatshme, të sakta ose kur ato janë shumë të gjera në lidhje me objektivat e përpunimit. Kjo përfshin njoftimin e Palës tjetër për çdo korrigjim, fshirje ose bllokim;

f) të dhënat personale mund të dorëzohen vetëm tek autoritetet kompetente. Transferimi i mëtejshëm tek autoritetet e tjera kërkon pëlqimin paraprak të autoritetit paraqitës;

g) autoriteti paraqitës dhe autoriteti pranues, janë të detyruar të përgatisin një konfirmim me shkrim për transmetimin dhe marrjen e të dhënave personale.

2. Palët dhe personat që vihen në dijeni me të dhënat personale të përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

3. Autoritetet kompetente të Palëve do të shkëmbejnë dhe ruajnë informacionin e klasifikuar, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, që i referohet mbrojtjes së informacionit të klasifikuar dhe vetëm për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

4. Autoritetet kompetente të Palëve, të cilat për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të transmetojnë dhe shkëmbejnë të dhëna personale dhe informacion të klasifikuar, do të jenë:

- Për Ministrinë e Brendshme të Republikës së Shqipërisë: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

- Për Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut: Byroja për Siguri Publike, Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor.

Neni 8

Marrëdhëniet me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, ku Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Shqipërisë janë Palë Kontraktuese.

Neni 9

Mundësia e ndërmarrjes së masave të tjera të përbashkëta

Autoritetet kompetente të Palëve do të rezervojnë mundësinë për të rënë dakord për ndërmarrjen e masave të tjera të përbashkëta të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Gjuha e punës

Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve do të komunikojnë në gjuhën maqedonase, shqipe ose angleze.

Neni 11

Zbatimi dhe interpretimi i dispozitave

1. Palët do të monitorojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe, nëse është e nevojshme, do të bëjnë ndryshimet e duhura.

2. Të gjitha ndryshimet në interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me konsultime ndërmjet Palëve.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave ligjore të parashikuara në legjislacionin e tyre kombëtar për hyrjen e tij në fuqi.



Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve. Çdo ndryshim do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me procedurën e parashikuar për hyrjen në fuqi.

Nënshtuar në Shkup, më 14.11.2022, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, maqedonase dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëllë autente. Në rast të dallimeve në interpretim, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bledar Çuçi
MINISTËR

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT

Oliver Spasovski
MINISTËR

DEKRET

Nr. 47, datë 31.3.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 22/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Maqedonisë së Veriut për krijimin e task-forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 23/2023

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR DELEGIMIN E SHËRBIMEVE TË TRAFIKUT AJROR NË NJË PJESË TË HAPËSIRËS AJRORE MBI LIQENIN E OHRIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për delegimin e shërbimeve të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 16.3.2023.

Shpallur me dekretin nr. 48, datë 31.3.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.



MARRËVESHJE
PËR DELEGIMIN E SHËRBIMEVE TË
TRAFIKUT AJROR

Preambulë

Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për delegimin e shërbimeve të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë si Shtet Delegates dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut si Shteti Ofrues i Shërbimit (në vijim: “Palët Kontraktore”);

Me vullnetin e mirë të realizimit të sigurt të operacioneve të fluturimeve ndërkombëtare përtej kufijve të përbashkët shtetërorë, në Ohër, aeroporti “St.Paul’s Apostle”, në interes të përdoruesve të hapësirës ajrore dhe pasagjerëve të tyre;

Me qëllim promovimin e marrëdhënieve të shërbimeve të trafikut ajror ndërmjet Shteteve Kontraktore që të përfitojnë në mënyrë reciproke;

Duke qenë Palë në Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, e hapur për nënshkrim në Çikago, më datë 7 dhjetor 1944 (në vijim: “Konventa e Çikagos”) dhe duke dashur të lidhin një marrëveshje me qëllim ofrimin e Shërbimeve të Trafikut Ajror sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të rekomanduara të parashikuara në shtojcën 11 të Konventës së Çikagos, përtej dhe matanë territoreve të tyre përkatëse;

Duke iu referuar Strategjisë Institucionale ECAC për ATM-në në Evropë dhe Protokollit që konsolidon Konventën Ndërkombëtare të EUROCONTROL-it në lidhje me bashkëpunimin për Sigurinë e Lundrimit Ajror, e cila u hap për nënshkrim më datë 27 qershor 1997 (Konventa e rishikuar);

Duke pranuar se përfundimi i një marrëveshjeje ndërmjet shteteve në lidhje me delegimin e ATS-së nuk cenon parimin që çdo shtet zotëron sovranitet të plotë dhe ekskluziv për hapësirën ajrore mbi territorin e tij ose kapacitetin e çdo shteti për të ushtruar të drejtat e tij për sa i takon sigurisë dhe mbrojtjes së hapësirës përkatëse ajrore kombëtare;

Duke pranuar se qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të adresojë aspektet ligjore dhe institucionale të delegimit të ATS-së dhe të lejojë autoritetet e përfshira të nivelit më të ulët që të negociojnë dhe

të miratojnë me nënshkrim Dokumentin e Marrëveshjes që përmban aspekte specifike operacionale dhe teknike lidhur me këto çështje.

Palët bien dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe, termi:

1. “*Marrëveshje*” nënkupton këtë Marrëveshjeje, Shtojcat e saj dhe çdo ndryshim të saj.

2. “*Shërbim i trafikut ajror*” si term i përgjithshëm përfshin shërbimin e informacionit të fluturimit, shërbimin e alarmit, shërbimin këshillues për trafikun ajror, shërbimin e kontrollit të trafikut ajror të ofruar nga Shtetet Kontraktore.

3. “*Autoriteti përkatës i ATS-së*” nënkupton autoritetin përkatës të caktuar nga shteti kontraktor përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror në hapësirën ajrore në fjalë.

4. “*Konventa e Çikagos*” nënkupton Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, të hapur për nënshkrim në Çikago më datë 7 dhjetor 1944 dhe përfshin:

a) çdo amendament të saj që është ratifikuar nga të dyja Shtetet Kontraktore dhe ka hyrë në fuqi sipas nenit 94a të Konventës; dhe

b) çdo shtojcë ose çdo amendament të tij të miratuar sipas nenit 90 të Konventës, për aq sa standardet ndërkombëtare të përmendura në nenin 37 të Konventës në këtë shtojcë ose amendament janë në çdo kohë efektive për të dyja Shtetet Kontraktore.

5. “*Autoritetet Kompetente*” (AK) nënkuptojnë një ose më shumë subjekte të përcaktuara nga një Shtet Kontraktues dhe që kanë kompetencat e nevojshme dhe përgjegjësitë e caktuara për kryerjen e detyrave që lidhen me certifikimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin.

6. “*Delegimi i ATS-së*” nënkupton delegimin e përgjegjësisë për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror nga një Shtet (Shteti Delegates) në një Shtet tjetër (Shteti Ofrues i Shërbimit) në një pjesë të hapësirës ajrore që shtrihet mbi territoret e të parit.

7. “*TPA*” ose *Trafiku i Përgjithshëm Ajror* nënkupton fluturimet e kryera në përputhje me rregullat dhe dispozitat e ICAO-s.

8. “*TAO*” ose *Trafiku Ajror Operacional* nënkupton fluturimet që nuk realizohen në



përputhje me dispozitat e parashikuara për TPA-në dhe për të cilat rregullat dhe procedurat janë specifikuar nga autoritetet përkatëse.

9. “Territor” në lidhje me një shtet, ka kuptimin e specifikuar në nenin 2 të Konventës së Çikagos.

Neni 2

Autorizimi për një nivel më të ulët Autoritetet (AK/Njësia e ATS-s/Autoritetet e ATS-së)

1. Shtetet Kontraktore bien dakord që përgjegjësia për kontrollin e trafikut ajror do të transferohet nga një njësi e ATS-së së Shtetit Delegates në një njësi tjetër të ATS-së në një Shtet Ofrues të shërbimit fqinj, sipas dispozitave të përcaktuara në shtojcën 11 dhe sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

2. Informacioni i kontrollit në lidhje me transferimin do të shkëmbehet ndërmjet njësive të ATS-së në fjalë duke pasur parasysh rregulloret kombëtare në fuqi dhe rrethanat lokale.

3. Shteti delegues bie dakord që njësia përkatëse e ATS-së së Shtetit Ofrues të shërbimit të ofrojë shërbime të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore të Shtetit Delegates, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

4. Për këtë qëllim, Shtetet Kontraktore autorizojnë njësitë e tyre përkatëse të ATS-së për të nënshkruar Dokumentin e Marrëveshjes (DM).

5. Ky Dokument Marrëveshjeje (DM) përcakton pjesën e hapësirës ajrore në fjalë dhe specifikon rregullat dhe procedurat që do të zbatohen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe ndjek strukturën e Dokumentit të Marrëveshjes me Format të Përbashkët EUROCONTROL (në vijim referuar si: Dokumenti i Marrëveshjes me Format të Përbashkët).

6. Shtetet Kontraktore autorizojnë autoritetet e tyre kompetente për të nënshkruar Dokumentin e Marrëveshjes (DM) mbi mbikëqyrjen për shërbimet e ofruara në një pjesë të hapësirës ajrore të Shtetit Delegates.

Neni 3

Zbatimi i rregullave dhe procedurave

1. Rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë me ofrimin e ATS-së në Shtetin Ofruesi të Shërbimit

do të zbatohen kur ATS-ja ofrohet në një pjesë të hapësirës ajrore të Shtetit Delegates.

2. Shteti Delegates dhe Shteti Ofrues i Shërbimit informojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të statusit operacional të objekteve të tyre të komunikimit dhe/ose të navigimit që mund të ndikojnë në ofrimin e ATS-së në pjesën e hapësirës ajrore ku është deleguar përgjegjësia për ofrimin e ATS-së.

Neni 4

Marrëveshjet financiare

1. Çdo Shtet Kontraktor mbart kostot e çdo aktiviteti të kryer prej tij sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe nga Shtetet Kontraktore.

2. Paraqitja e marrëveshjeve financiare kërkon marrëveshje paraprake me shkrim ndërmjet përfaqësuesve përkatës të Shteteve Kontraktuese.

Neni 5

Përgjegjësia civile

1. Shteti Ofrues i Shërbimit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar si pasojë e pakujdesisë së tij, e agjentëve të tij ose e çdo personi tjetër që vepron në emër të tij, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

2. Paditë kundër Shtetit Ofrues i Shërbimit, agjentëve të tij ose çdo personi tjetër që vepron në emër të tij dërgohen në gjykatë dhe janë subjekti i legjislacionit të Shtetit Ofrues i Shërbimit.

3. Shteti Delegates mund të ngrejë një padi kundër Shtetit Ofrues të shërbimit për të marrë mbrapsht çdo kompensim ose kosto të paguar ose të shkaktuar si rezultat i humbjes ose dëmit të shkaktuar nga pakujdesia e Shtetit Ofrues të shërbimit, agjentëve të tij ose çdo personi tjetër që vepron në emër të tij, gjatë zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

4. Shteti Ofrues i Shërbimit mban përgjegjësi për dëmet që mund të shkatohen nga Ofruesi i Shërbimit lidhur me këtë Marrëveshje.

Neni 6

Certifikimi, licencimi, trajnimi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme

1. Shtetet Kontraktore bien dakord që certifikata për Ofruesi të Shërbimeve të Navigimit



Ajror (OSHNA) e cila përfaqëson një licence për kontrollimin e trafikut ajror që lëshohet nga Shteti Ofrues i Shërbimit, është e vlefshme për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror në pjesën e hapësirës ajrore të Shtetit Delegates në të cilën delegohet përgjegjësia për ofrimin e ATS-së.

2. Trajnimi i personelit të ATS-së së Shtetit Ofrues të shërbimit që ofron ATS-në në pjesën e hapësirës ajrore të Shtetit Delegates përfshin kërkesat që i përkasin hapësirës ajrore në fjalë.

3. Mbikëqyrja e vazhdueshme do të kryhet sipas marrëveshjes së autoriteteve kompetente bazuar në nenin 2, paragrafi 6.

Neni 7

Avionët shtetërorë

1. Avionët shtetërorë përveç atyre të Shtetit Delegates nuk do të hyjnë në atë pjesë të hapësirës ajrore ku përgjegjësia për sigurimin e ATS-së është deleguar pa leje diplomatike paraprake ose leje të posaçme nga Shteti Delegates.

2. Për avionët shtetërorë që operojnë në TPA do të zbatohen të njëjtat rregulla dhe procedura si për trafikun ajror civil, por kur është e nevojshme, duhet të krijohen procedura të veçanta për të lejuar aksesin e tyre në hapësirën ajrore. TAO do të jetë subjekt i koordinimit paraprak ndërmjet njësive ushtarake dhe njësive të ATS-së në fjalë.

Neni 8

Procedurat e koordinimit dhe ngjarjeve të paparashikuara për arsye ushtarake dhe të tjera

1. Dokumenti i Marrëveshjes (DM) plotësohet nga procedurat e koordinimit dhe ngjarjet e paparashikuara të përcaktuara nga njësitë përkatëse.

2. Njësia e ATS-së së Shtetit Ofrues të shërbimit siguron për autoritetet/njësitë ushtarake përkatëse të Shtetit Delegates planet përkatëse të fluturimit dhe të dhëna të tjera lidhur me fluturimet në hapësirën ajrore në të cilën është deleguar përgjegjësia për ofrimin e ATS-së.

Neni 9

Kërkim shpëtimi

1. Palët kontraktuese autorizojnë qendrat e tyre nacionale të koordinimit të shpëtimit për të vendosur një marrëveshje koordinimi për të

lehtësuar kërkim shpëtimit (SAR) në zonën në fjalë siç përshkruhet në aneksin 12, kapitulli 3, të ICAO-s.

2. Mbulimi me shërbimin e kërkim shpëtimit (SAR) do të harmonizohet në fillim të vitit nëpërmjet letër marrëveshjes dypalëshe (leje vjetore (*clearance*)), për mbështetje në rast të një aksidenti ajror.

Neni 10

Publikimi

Shtetet Kontraktore bien dakord për përmbajtjen dhe publikojnë të gjithë informacionin përkatës në lidhje me pjesën e hapësirës ajrore, ku është deleguar përgjegjësia për ofrimin e ATS-së, në Paketën e tyre të informacionit aeronautik siç përcaktohet në shtojcën 15, të Konventës së Çikagos.

Neni 11

Hetimi i aksidenteve ose incidenteve të rënda

1. Një Shtet Delegates do të nisë një hetim për rrethanat e aksidenteve ose incidenteve të rënda që ndodhin në territorin e tij.

2. Hetimi fillestar kryhet nga njësia e ATS-së së Shtetit Kontraktor ku është raportuar incidenti i trafikut ajror.

3. Njësia e ATS-së së Shtetit Delegates siguron materialet e nevojshme për Shtetin e Ofrimit të shërbimit, me kërkesën e këtij të fundit, nga (p.sh. regjistrimet e të dhënave të radarit, transkriptimet e kasetave etj.), në mënyrë që ky i fundit të mund të kryejë një hetim për një aksident ose incident të rëndë që ka ndodhur në territorin e vet.

4. Shteti Ofrues i Shërbimit ka leje të caktojë vëzhgues që të jenë të pranishëm gjatë hetimit, ndërsa Shteti Delegates komunikon raportin dhe gjetjet e hetimit të Shtetit Ofrues i Shërbimit.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Shteteve Kontraktore në lidhje me interpretimin ose zbatimin e ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje, pala në fjalë përpiqet në radhë të parë ta zgjidhë atë me negociata.

2. Nëse Shtetet Kontraktore nuk arrijnë të zgjidhin ndonjë mosmarrëveshje me anë të



negociatave, mosmarrëveshja paraqitet për vendim përfundimtar te një palë e tretë (arbitrazhit) që është caktuar nga të dy Shtetet Kontraktore, në përputhje me rregullat zbatueshme të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ICC në Paris dhe do të zbatohet ligji detyrues zviceran.

3. Shtetet Kontraktore ndajnë në mënyrë të barabartë kostot e arbitrazhit, duke përfshirë tarifatat dhe shpenzimet e tij.

Neni 13

Zgjidhja/pezullimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet nga secili Shtet Kontraktor në çdo kohë duke njoftuar me shkrim Shtetin tjetër Kontraktor. Zgjidhja e marrëveshjes hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Shteti tjetër Kontraktor.

2. Në rast lufte, gjatë një periudhe emergjence ose në interes të sigurisë publike, ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme, çdo Shtet Kontraktor gëzon të drejtën për të pezulluar ose të zgjidhur Marrëveshjen me efekt të menjëhershëm dhe njofton Shtetin tjetër Kontraktor në përputhje me rrethanat.

3. Dokumenti i Marrëveshjes që përmendet në nenin 2(5) përmban dispozitatë në lidhje me pezullimin dhe zgjidhjen e marrëveshjes.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi sapo Shtetet Kontraktore të njoftojnë njëri-tjetrin me shkrim mbi plotësimin e kërkesave të tyre ligjore përkatëse.

Neni 15

Ndryshimet

1. Nëse një Shtet Kontraktor dëshiron të ndryshojë ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, ai mund të konsultohet me Shtetin tjetër Kontraktor. Çdo ndryshim i rënë dakord nga Shtetet Kontraktore hyn në fuqi pasi të konfirmohet nga shkëmbimi i komunikimeve në rrugë zyrtare.

2. Ndryshimet e DM-së siç përshkruhet në nenin 2, paragrafit 4 dhe 5, mund të përcaktohen së bashku nga Njësit/Autoritetet përkatëse të ATS-së

së Shteteve Kontraktore, por nuk duhet të bien ndesh me dispozitatë e kësaj marrëveshjeje.

Neni 16

Masat e përkohshme për marrëveshjet tashmë në zbatim

Marrëveshjet që janë në zbatim në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje vlerësohen për rishikim të mundshëm në përputhje me dispozitatë e përcaktuara në këtë Marrëveshjeje.

Neni 17

Regjistrimi në ICAO

Kjo Marrëveshje regjistrohet në Këshillin e ICAO-së (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil), në përputhje me dispozitatë e nenit 83 të Konventës së Çikagos.

Në dëshmi të sa më sipër, të nënshkruarit, të cilët janë të autorizuar sipas ligjit nga qeveritë e tyre përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshjeje.

Nënshkruar në dy kopje , më2022 në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze. Teksti në gjuhën angleze mbizotëron në rast se ka ndonjë mospërputhje në interpretimin e tekstit.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Belinda Balluku

Zëvendëskryeministër, Ministër i Infrastrukturës
dhe Ekonomisë

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT

Bllagoj Boçvarski

Ministër i Transportit dhe Lidhjeve

DEKRET

Nr. 48, datë 31.3.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 23/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së



Maqedonisë së Veriut për delegimin e shërbimeve të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 51, datë 3.4.2023

**PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “P”, të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 5, të ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, të ndryshuar, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Vlora Ramush Hyseni emërohet në detyrën e drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 7, datë 27.3.2023

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN
NR. 35, DATË 21.9.2020, “PËR
KONTROLLIN, REGJISTRIMIN,
PËRDORIMIN, RAKORDIMIN,
RAPORTIMIN DHE PUBLIKIMIN E
FONDEVE TË FINANCIMEVE TË HUAJA
NË KUADRIN E MARRËVESHJEVE
NDËRKOMBËTARE”**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 6 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, në kushtet kur institucionet e pavaruara nënshkruajnë marrëveshje dhurimi/granti me institucionet ndërkombëtare dhe shtetet e huaja, ministri përgjegjës për financat e qeverisë,

UDHËZON:

1. Pas paragrafit 4.2 të udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

4.2 –

Përjashtim nga ky rregull bëjnë institucionet e pavarura të cilat nënshkruajnë marrëveshje dhurimi / granti nga institucionet ndërkombëtare dhe shtetet e huaja, vetëm kur këto marrëveshje nuk parashikojnë angazhime shtesë për buxhetin e shtetit apo nuk janë të parashikuara në buxhetin e institucionit përkatës.

Kërkesa për hapjen e llogarisë speciale të projekteve të huaja në Bankën e Shqipërisë nga nëpunësi autorizues i institucionit të pavarur / njësisë së zbatimit të projektit të financimit të huaj grant urdhërohet nga ministri përgjegjës për financat dhe i adresohet strukturës përgjegjëse për Thesarin sipas formatit në aneksin nr. 4.2 bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen institucionet e pavarura dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj



ANEKS 4.2

Kërkesa për hapjen e llogarisë speciale në Bankën e Shqipërisë

I. Kërkesa e NJZP për DPTthesarit:



REPUBLICA E SHQIPËRISË

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2023

Lënda: Kërkesë për çelje llogarie speciale

Referencë:

Z/ZNJ. _____

MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË
ADRESA: BLV "DËSHMORËT E KOMBIT", NR. 3, TIRANË

I/E nderuar _____,

Mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj", ju paraqesim kërkesën për çeljen e llogarisë speciale në Bankën e Shqipërisë për projektin "... Leader x%" me specifikimet e mëposhtme:

- a) Emërtimi i llogarisë që kërkohet të hapet (i njëjtë me emërtimin e projektit);
- b) Lloji i financimit (grant ose kredi);
- c) Emërtimi i donatorit ose kreditorit;
- ç) Monedha e disbursimit;
- d) Shuma e financimit të huaj;
- dh) Shuma e transhit të parë;
- e) Koha e përfaqësimit kur mbërrin transhi i parë;
- f) Kontakt email/telefon

Kërkesa bazohet në marrëveshjen teknike të dhurimit/grantit të nënshkruar me institucionet ndërkombëtare dhe qeveritë e shteteve të huaja, e cilat gjenden bashkëlidhur kësaj kërkesë.

Lutemi njoftimin e numrit të llogarisë në momentin e çeljes pranë institucionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

TITULLARI
Emër Mbiemër
Firmë



UDHËZIM

Nr. 9 datë, 29.3.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 26.4.2019,
“PËR LLOJET, PROCEDURAT DHE
MËNYRAT PËR LËSHIMIN E
CERTIFIKATAVE, SI DHE FORMATET
QË DO TË PËRDOREN NË SISTEMIN E
ARSIMIT DHE FORMIMIT
PROFESIONAL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 29, pika 4, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; dhe të nenit 8, shkronja “ë”, dhe nenit 14 dhe të shtojcës 1, të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve” (KSHK), të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 16, datë 26.4.2019, “Për llojet, procedurat dhe mënyrat për lëshimin e certifikatave, si dhe formatet që do të përdoren në sistemin e arsimit dhe formimit profesional”, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2 bëhet ndryshimi si më poshtë:

“2. Në përfundim të klasës X për strukturën arsimore 2+1+1, të klasave X dhe XII, për strukturën arsimore 2+2, të klasave X, XI dhe XII për strukturën arsimore bllok 4-vjeçar dhe të klasës I për arsimin pas të mesëm (2-vjeçar), të gjithë nxënësit pajisen me dëftesë klase.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë :

3. “Dokumentet e certifikimit në arsimin profesional pasqyrojnë rezultatet e arritjeve të nxënësve në përfundim të kualifikimeve profesionale të niveleve 2, 3, 4 dhe 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), respektivisht të barasvlershme me nivelet 2, 3, 4 dhe 5 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK)”.

3. Pika 4 shfuqizohet.

4. Në pikën 6, pas togfjalëshit “Matura Shtetërore” shtohet togfjalëshi “Profesionale”.

5. Në pikën 7, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) Certifikata profesionale e nivelit është dokumenti i lëshuar nga institucionet ofruese të arsimit profesional për nxënësit, që përmbushin me sukses një kualifikim profesional të caktuar të

niveleve 2–5 të KSHK-së. Certifikata profesionale e nivelit është e vlefshme e shoqëruar me suplementin e saj”.

6. Në pikën 7 pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f”, me përmbajtje si më poshtë:

“f) Suplementi i certifikatës profesionale është dokumenti që shoqëron certifikatën profesionale të nivelit dhe që përmban të dhëna për rezultatet e nxënësit si dhe kualifikimin përkatës.”.

7. Në pikën 8.1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) shkronja “f” ndryshohet si më poshtë:

“f) Emërtimin e kualifikimit profesional përkatës”;

b) shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) Nivelin e kualifikimit profesional në KSHK dhe referencën përkatëse në KEK”;

c) pas shkronjës “n” shtohet një shkronja “nj” me përmbajtje, si më poshtë:

“nj) Referencën ligjore për modelin e certifikatës”.

8. Në pikën 8.2 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) shkronja “f” ndryshohet si më poshtë:

“f) Emërtimin e kualifikimit profesional përkatës”;

b) shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) Nivelin e kualifikimit profesional të përfutur, në KSHK dhe referencën përkatëse në KEK”.

9. Në pikën 8.3 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) shkronja “f” ndryshohet si më poshtë:

“f) Emërtimin e kualifikimit profesional përkatës”;

b) shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) Nivelin e kualifikimit profesional të përfutur, në KSHK dhe referencën përkatëse në KEK”;

c) shkronja “i” ndryshohet si më poshtë:

“i) Listën e lëndëve/moduleve, kohëzgjatjet e tyre (orët mësimore) dhe rezultatet (notat) e nxënësit, për çdo vit shkollor”.

ç) shkronja “j” ndryshohet si më poshtë:

“j) Rezultatet (notat) e provimeve përfundimtare të nivelit;”

d) shkronja “l” ndryshohet si më poshtë:

“l) Listën e kompetencave profesionale të kualifikimit profesional përkatës”;

dh) shkronja “m” ndryshohet si më poshtë:

“m) Mundësitë e punësimit në përfundim të kualifikimit profesional”

e) shkronja “n” ndryshohet si më poshtë:



“n) Referencën ligjore për modelin e suplementit të certifikatës”;

ë) pas shkronjës “n” shtohet shkronja “nj” si më poshtë:

“Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm në përfundim të kualifikimit profesional”

10. Në pikën 8.4 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Shkronja “P”, ndryshohet si më poshtë:

“f) Të dhënat për kursin e unifikuar: emërtimin, kohëzgjatjen (orët mësimore), kodin, datën e fillimit dhe të mbarimit të kursit”;

b) shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) Listën e moduleve, kohëzgjatjet e tyre (orët mësimore) dhe rezultatet (notat) përkatëse të kursantit”;

c) shkronja “h” ndryshohet si më poshtë:

“h) Rezultatin (notën) e provimit përfundimtar të kursit”;

11. Në pikën 8.5 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) shkronja “P” ndryshohet si më poshtë:

“f) Të dhënat për kursin e veçantë të formimit profesional: emërtimin, kohëzgjatjen (orët mësimore), datën e fillimit dhe të mbarimit të kursit”;

b) shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) Rezultatin (notën) e provimit përfundimtar të kursit të veçantë (nëse aplikohet)”;

c) pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me përmbajtje si më poshtë:

“gj) Listën e njësive mësimore (module, lëndë, tema, projekte etj.), kohëzgjatjet e tyre (orët mësimore) dhe rezultatet (notat) përkatëse të kursantit (nëse aplikohet)”;

12. Në pikën 8.6 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) Emrin e institucionit ofrues të formimit profesional, që lëshon vërtetimin”;

b) shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) Listën e njësive mësimore (module, lëndë, tema, projekte etj.) në të cilat kursanti ka marrë pjesë dhe rezultatet (notat) e fituara”.

13. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

URDHËR

Nr. 180, datë 29.3.2023

PËR PËRDITËSIMIN E URDHËRIT TË MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017, “PËR MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Rinovohet regjistrimi për 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca



RINOVOHET REGJISTRIMI (RIREGJISTRIM) PËR LËNDËN VEPRUESE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Abamectin CAS No 71751-41-2 Avermectin B1a CAS No 65195-55-3 Avermectin B1b CAS No 65195-56-4 Abamectin CIPAC No 495	Avermectin B1a (10E,14E,16E)-(1R,4S,5'S,6S,6'R,8R,12S,13S,20R,21R,24S)-6'-[(S)-sec-butyl]-21, 24-dihydroxy-5',11,13, 22-tetramethyl-2-oxo-(3,7,19-trioxatetracyclo[15.6.1.14,8,020,24]pentacos-10,14,16,22-tetraene)-6-spiro-2'-(5',6'-dihydro-2'H-pyran)-12-yl 2,6-dideoxy-4-O-(2,6-dideoxy-3-O-methyl- α -L-arabino-hexopyranosyl)-3-O-methyl- α -L-arabino-hexopyranoside Avermectin B1b (10E,14E,16E)-(1R,4S,5'S,6S,6'R,8R,12S,13S,20R,21R,24S)-21, 24-dihydroxy-6'-isopropyl-5',11,13, 22-tetramethyl-2-oxo-(3,7,19-trioxatetracyclo[15.6.1.14,8,020,24]pentacos-10,14,16,22-tetraene)-6-spiro-2'-(5', 6'-dihydro-2'H-pyran)-12-yl 2,6-dideoxy-4-O-(2,6-dideoxy-3-O-methyl- α -L-arabino-hexopyranosyl)-3-O-methyl- α -L-arabino-hexopyranoside	\geq 850 g/kg. abamectin (shuma e avermectin B1a dhe avermectin B1b): min. 800 g/kg avermectin B1a dhe max. 200 g/kg avermectin B1b.	1.4.2023	31.3.2038	Mund të autorizohen vetëm përdorime që lejojnë shkëmbimin e kontrolluar të materialit dhe energjisë me mjedisin përreth dhe parandalojnë lëshimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve në mjedis, veçanërisht përdorimet në serra të përhershme. Të kushtohet vëmendje e veçantë për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke siguruar që kushtet e përdorimit përfshijnë aplikimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale, si përdorimi i dorezave; - efektin e fotolizës në nivelet e mbetjeve të pesticideve në kultura. - Vëmendje e veçantë kërkohet për të siguruar që provat e disponueshme të mbetjeve në të korrat, pasqyrojnë situatën më kritike të mbetjeve. Kur është e përshtatshme, në varësi të zonës, të zbatohen kufizime sezonale për kohën e aplikimit.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë